

# GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr. 2147/09

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, përmes gjyqtares Franciska Fiser, duke vepruar sipas vendimit të Gjyqtarit të EULEX-it e deleguar nga Kryetari i Kuvendit të Gjyqtareve të EULEX-it, më 28 Nëntor 2012, në rastin civil të paditësit H.SH. nga Prishtina , Dardania S.U. - 3/2, Hyrja A, Kati II, banesa nr. 11 i përfaqësuar nga avokati mbrojtës Naser Peci nga Prishtina kundër të paditurit M. M. nga Prishtina , me banim të përkohshëm ne Serbi , i përfaqësuar nga avokati Z. J. nga Prishtina si dhe Biblioteka Kombëtare Universitare nga Prishtina e përfaqësuar nga I. A. për anulimin e kontratës të shitblerjes dhe verifikimin e të drejtës se pronësisë, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, pas seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me 18 Prill 2013 dhe letrës se pranuar me 17 Maj 2013, nxjerr këtë:

## AKTGJYKIM

### I.

Kërkese padia në vijim:

*“ Deklarata e padisë së paditësit H.Sh. nga Prishtina pranohet si e bazuar”.*

*Vërtetohet se kontrata nr. 973 e lidhur me 11 Nëntor 1993 në mes të Bibliotek;s Kombëtare Universitare dhe të paditurit M. M. si blerës nuk është valide- absolutisht e pavlefshme.*

*Vërtetohet se paditësi H. Sh. nga Prishtina ka të drejtën e banimit e cila gjendet në Prishtinë, Dardania S.U. -3/2, hyrja A kati i dytë , nr. 11 me sipërfaqe prej 58,11 m2, duke u bazuar ne kontratën mbi përdorimin e banesës nr. 1193/11934 të datës 20 Korrik 1984.*

*I padituri është i obliguar të paguaj shpenzimet procedurale brenda 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim jepet, nën kërcënimin e ekzekutimit me forcë”.*

është refuzuar.

## II.

Paditësi urdhërohet të paguaj shumën prej 300 EUR për shpenzimet procedurale. Brenda periudhës prej 15 ditëve pas pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të ekzekutimit.

### A r s y e t i m i

Paditësi ka paraqitur një padi tek Gjykata Komunale e Prishtinës me 7 Shtator 2006 kundër të paditurit të parë duke kërkuar aprovimin e padisë së tij dhe për të vërtetuar se paditësi është personi me të drejtë banimi të banesës në Prishtinë, Dardania S.U. -3/2, hyrja A kati i dytë , nr. 11 me sipërfaqe prej 58,11 m<sup>2</sup>, duke u bazuar në kontratën mbi përdorimin e banesës nr. 1193/11934 të datës 20 Korrik 1984 përmes së cilës i padituri është i obliguar të pranojë këtë të drejtë paditësit dhe të mos ndërmer asnjë veprim me të cilin ai do të pengonte paditësin në realizimin e të drejtave të tij.

Paditësi pretendoi në padinë e tij se ai ishte pronar i banesës në Prishtinë, Dardania S.U. -3/2, hyrja A kati i dytë , nr. 11 me sipërfaqe prej 58,11 m<sup>2</sup>. Banesa i ishte ndarë atij me vendimin nr. 495/3 të datës 6 Qershor 1984 i Bordit të ish- Bibliotekës Kombëtare Universitare të Kosovës , tani Biblioteka Kombëtare Universitare. Pas ndarjes së banesës paditësi nënshkroi kontratën me Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) mbi përdorimin e banesës nr. 1193/11934 me datën 20 Korrik 1984 dhe ligjërisht u vendos në banesë me familjen e tij ku jetoi deri në vitin 1993.

Në vitin 1993 masat e dhunshme u vendosën në Bibliotekë nga qeveria e Serbisë të instaluar në Kosovë pas vitit 1989 banesa u mor, paditësi u dëbua nga banesa me dhunë dhe i padituri i parë u vendos në banesë.

Paditësi inicioi procedurën për kthimin e banesës tek Departamenti për Banim dhe Pronë (DBP) si aplikues i kërkesës së kategorisë A pasi se banesa ishte marrë mbi baza diskriminuuese. Komisioni i shkallës së parë e miratoi kërkesën, sidoqoftë në procedurën e rishqyrtimit kërkesa e

tij u refuzua duke e udhëzuar paditësin që ti drejtohet gjykatës kompetente që të vlerësoj mënyrën se si banesa në fjalë i ishte ndare të paditurit të parë.

Paditësi gjithashtu pretendoi se ai u vendos ne banese ne baze të kontratës për shfrytëzim dhe se në pajtim me Nenin 11 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore ai mori të drejtën banesore dhe të drejtën për përdorim të përhershëm në pajtim me Nenin 2 paragrafi 1 i ligjit të njëjte. Bazuar në Nenin 19 të ligjit, e drejta e banimit mund të përfundoj ne raste dhe mënyra të definuara me ligj në Nenet 45 dhe 58. Në rastin e paditësit këto procedura nuk ishin respektuar.

Gjykata e shkalles se parë me aktgjykimin e 8 Prillit 2008 hodhi poshtë padinë si të pabazuar.

Pas ankesës së parashtruar nga paditësi, gjykata e apelit me aktvendimin e saj të datës 9 Shtator 2009 anuloi aktgjykimin e shkalles se parë dhe kthej edhe një here rastin tek gjykata e shkalles së parë për rigjykim.

Gjykata e apelit miratoi pretendimet ankimore të paditësit se situata faktike është përcaktuar gabimisht me arsyetim se gjykata e shkalles se parë nuk e ka vlerësuar faktin që ka të bëjë me rrjedhjen e procedurës të Gjykatës Themelore për Pune të Bashkuar në Prishtinë , filloi më 1984 dhe Gjykata e Punës së Bashkuar e Kosovës ka filluar të funksionoj në 1985.

Në bazë të udhëzimeve të gjykatës së apelit gjate rigjykimit, gjykata e shkalles se parë duhet ti evitoj gabimet në harmoni me këto vërejtje, kështu që palët duhet të udhëzohen që ta paraqesin në gjyq vendimin e Gjykatës Themelore të Punës se Bashkuar në Prishtinë dhe Gjykatës së Punës se Bashkuar të Kosovës.

Me parashtrësën e datës 20 Tetor 2011 paditësi zgjeroi padinë edhe kundër te paditurit të dytë dhe ndryshoi padinë duke kërkuar që te vërtetohet se kontrata nr. 973 e lidhur me 11 Nëntor 1993 në mes të Bibliotekës Kombëtare Universitare dhe te paditurit M. M. si blerës, nuk është e vlefshme – absolutisht e pavlere dhe se të vërtetohet se paditësi H.Sh. nga Prishtina është personi që ka të drejtën banesore të banesës në adresën Dardania S.U. -3/2, hyrja A kati i dytë , nr. 11 me sipërfaqe prej 58,11 m2, duke u bazuar në kontratën për shfrytëzim të banesës nr. 1193/11934 të datës 20 Korrik 1984.

Në parashtrësën e tij, i padituri pretendoi se kontrata e shitblerjes se banesës datonte 11 Nëntor 1993 dhe është në kontradikte me normat thelbësore ligjore, pra si e tille është invalide në

kuptimin e Nenit 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, kështu që si i tillë ishte dashur të shpallet plotësisht i pavlefshëm. Kur Ligji mbi Banimin hyri në fuqi në mes të viti 1992 paditësi fitoi mundësinë që të blej banesën në pajtim me Nenin 16 pasi që ai ishte personi i cili kishte të drejtën e banimit sipas kontratës nr. 1193/11394 të datës 20 Korrik 1984. Kontrata e blerjes së banesës nr. 973 mbante datën 11 Nëntor 1993 dhe u lidh në mes të paditurve të parë dhe të dytë në kundërshtim me Nenin 16 të Ligjit mbi Banimin. Si e tillë ajo nuk është valide, dhe gjykata në kuptim të Nenit 103 do të duhej të shpallte të njëjtin si plotësisht të pavlefshme.

Me aktvendimin e datës 28 Nëntor 2012 të lëshuar nga Nën-Kryetari i Kuvendit të Gjyqtareve të EULEX-it rasti mund të merrej përsipër në ingerencat e gjyqtarëve të EULEX-it dhe të caktohet tek Gjyqtarët Civil të EULEX-it, tek Njësia Mobile e Gjykatës Themelore në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Ndarjen e Lendeve, Ndarjen e Lendeve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

I padituri i parë parashtrori një përgjigje në padi, në të cilën ai e mohon pohimin në tërësi si të pabazuar.

Ai pretendoi se paditësi nuk ka sjellë fakte të reja në këtë padi dhe as nuk propozojnë prova të reja përveç atyre që ai paraqiti në procedurë të mbajtur në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore. Në vitin 1984 një konkurs u shpall në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare për ndarjen e 5 banesave. Pasi këshilli i punëtorëve mori një vendim për ndarjen e banesave, disa punonjës të bibliotekës (4 - 5 prej tyre) që të gjithë shqiptarë, kërkoj menjëherë mbrojtjen e të drejtave të tyre në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë. Me vendimin e tij ST-113/84 të datës 25 Korrik 1984 gjykata revokoi vendimin e këshillit të punëtorëve si të paligjshëm dhe obligoi bibliotekën për të bërë ri-ndarjen e apartamenteve. E njëjta gjykatë gjithashtu lëshoi aktvendimin ST nr. 112/84 të datës 6 Qershor 1984 dhe lëshoi një masë të përkohshme që suspendon ekzekutimin e vendimit të këshillit të punëtorëve në ndarjen e banesave dhe ndaloi vendosjen për banim në banesën e kontestuar, derisa vendimi përfundimtar të jetë lëshuar. Paditësi nuk veprroi në përputhje me masën e shqiptuar dhe u vendos në banesën kontestuese. Biblioteka apeloj aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar ST 113/84 por Gjykata e Punës së Bashkuar të Kosovës me aktvendimin Z nr. 1136/85 të datës 27 Dhjetor 1985 konfirmoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. I padituri i parë vuri në dukje

se gjykatësit e gjykatës së bashkuar ishin shqiptarët në atë kohë, dhe kryetari i Gjykatës së Punës së Bashkuar të Kosovës ishte Z. Ali Qosja dhe duke konsideruar faktet të tilla, paditësi nuk mund të thirret në diskriminim.

I padituri i dytë, gjithashtu parashtroi një përgjigje në padi, me 4 Shkurt 2013 në të cilën i padituri pretendoi se pas ekzaminimit të dokumentacionit ekzistues në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Kosovës mund të konfirmohet se duke u bazuar në Vendimin e Këshillit nr. 495/3 të 6 Qershorit 1984, banesa dy dhomëshe, e cila ndodhet në Prishtinë, adresa Dardania, S.U. 9/2, L-a, III, nr. 11 që përfshinë një sipërfaqe prej 60,43 m<sup>2</sup>, i ishte ndarë punëtorit H.Sh. Më 20 Korrik 1984 kontrata me numër 1193/11934 mbi përdorimin e banesës ishte nënshkruar me Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë.

Paditësi i dytë gjithashtu pretendoi se kur aplikimi i masave të detyrueshme që ndodhi në vitin 1990 në institucionin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare, paditësi më 14 Nëntor 1990 ishte dëbuar nga puna me forcë siç edhe shumica e punonjësve shqiptarë. Pasi ai u përjashtua nga puna, më 15 Korrik 1993 pasoi dëbimi i tij me forcë nga banesa e tij.

Në propozimin e palëve në padi dhe me qëllim për të konstatuar gjendjen faktike, gjykata prezantoi dhe të lexoi dëshmitë e mëposhtme:

- Vendimi mbi ndarjen e banesës nr. 495/3 të datës 6 Qershor 1984;
- Kontrata mbi përdorimin e banesës nr. 1193/11934, datë 20 Korrik 1984;
- Një faqe e gazetës "Bujku" datës 17 Korrik 1993;
- Vendimi DBP datës 18 Qershor 2005;
- Vendimi DBP datës 15 Korrik 2006;
- Vendimi i pushimit nga puna e tij nr. 467 të datës 14 Nëntor 1990;
- Vendimi për ndarjen e banesës nr. 728 të datës 17 Qershor 1993;
- Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës për periudhë të pakufizuar nr. 770 të datës 30 Qershor 1993;
- Kontrata e qirasë së banesës nr. 1193/11934 e datës 28 Korrik 1993;
- Kontrata e blerjes së banesës, të datës 11 Nëntor 1993;
- Vendimi mbi Zbatimin e Modifikimit në librat kadastrale datës 19 Nëntor 1993;

- Kontrata nr. 1193/973 për pjesëmarrjen e pronarëve për pjesë të veçanta të ndërtesës në lidhje me shpenzimet e mirëmbajtjes së ndërtesës dhe detyrimet e tjera datës 21 Shkurt 1994;
- Vendimi i ish Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë nr. 113/84 të datës 25 Korrik 1984;
- Vendimi i Gjykatës së Punës së Bashkuar të Kosovës nr. 1136/85 të datës 27 Dhjetor 1985;
- Dëgjimi i palëve të përfshira në kontest.

Duke vlerësuar çdo pjesë e provave veç e veç dhe si një të tërë me ndërgjegje dhe me kujdes dhe në pajtim me nenin 8 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), gjykata vjen në përfundim se kërkesë padia nuk mund të aprovohet.

Gjatë procedurës së provave u konstatua gjendja faktike si në vijim.

Me vendimin e Bordit të të paditurit të dytë nr. 495/3, datë 6 Qershor 1984 paditësit i ishte ndarë një banesë dy dhomëshe në Prishtinë, Dardania SU-3/2, hyrja A kati i dyte, banesa nr. 11 prej 58,11 m<sup>2</sup>.

Fakti që banesa dy dhomëshe në Prishtinë, Dardania SU-3/2, hyrja A kati i dyte, banesa nr. 11 prej 58,11 m<sup>2</sup> i ishte ndarë paditësit nuk është kontestuese mes palëve. Ka një mospërputhje në sipërfaqe të banesës, në krahasim me deklaratën e bërë nga paditësi i dytë, i cili në përgjigjen e tij në padinë e datës 4 Shkurt 2013 deklaroi se banesa në "Dardania" SU-9/2, La, III nr. 11 ka një sipërfaqe prej 60,43 m<sup>2</sup> dhe ishte ndarë për paditësin. Gjykata konsideron sipërfaqen prej 58,11 m<sup>2</sup> si të saktë.

Gjithashtu nuk është kontestuese se kontrata në përdorim nr. 1193/11934 është përpiluar më 20 Korrik 1984 në mes të paditësit dhe të paditurit e dytë.

Paraqitësi ka deklaruar në deklaratën e tij se ai u vendos në banesë kur kontrata për përdorim është nënshkruar dhe se ai ka jetuar në banesë deri në vitin 1993, kur ai dhe familja e tij u dëbuan nga banesa.

I padituri i parë kundërshtoi pretendimet e paditësit duke thënë se pasi vendimi për ndarjen e banesave është bërë, disa punonjës të paditurit të dytë i kërkuan mbrojtje të drejtave të tyre në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, i cila me vendimin e saj ST-113/84 të datës 25 Korrik 1984 revokoi vendimin e këshillit të punëtorëve si të paligjshëm dhe obligoi të paditurin e dytë për të bërë ri-ndarjen e banesave. E njëjta gjykatë gjithashtu lëshoi aktvendimin ST nr. 112/84 të datës 6 Qershor 1984 dhe lëshoi një masë të përkohshme mbi suspendimin e ekzekutimit të vendimit të këshillit të punëtorëve mbi ndarjen e banesave dhe ndaloi vendosjen në banesën e kontestuar deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë. I padituri i dytë parashtrroi ankese në aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar ST 113/84 por Gjykata e Punës së Bashkuar të Kosovës me vendimin Z nr. 1136/85 të datës 27 Dhjetor 1985 konfirmoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Bazuar në këto vendime i padituri i dytë paraqiti një propozim për dëbim nga banesa në vitin 1993 dhe paditësi ishte hequr/dëbuar nga banesa. Gjykata do të vlerësojë vendimet e Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar dhe Gjykatës së Punës së Bashkuar të Kosovës si dhe domethënien e tyre si dëshmi në një fazë të mëvonshme.

Më 14 nëntor 1990, është lëshuar vendimi me të cilin paditësi u shkarkua nga puna për shkak të shkeljes së rëndë të punës dhe detyrave të punës.

Në deklaratën e tij paditësi ka deklaruar se vendimi u mor në bazë të masave diskriminuese që ishin në fuqi në mes të 23 Marsit 1989 dhe 24 Mars 1999, e njohur si periudhë diskriminuese.

Pas dëbimit nga banesa të paditësit në vitin 1993 banesa e njëjtë i është ndarë paditurit të parë me vendimin nr. 728, të datë 17 Qershor 1993. Më vonë, më 30 Qershor 1993, është përpiluar kontrata mbi përdorim me nr. 770.

Pas kësaj i padituri i parë lidhi kontratë të qirasë së banesës nr. 1193/11934 me Ndërmarrjen Publike Banesore Prishtinë më 28 Korrik 1993. Më 11 Nëntor 1993 ai nënshkroi kontratën për blerje të banesës të lidhur ndërmjet tij dhe të paditurit të dytë.

I padituri si dhe paditësi i parë paraqitën padi tek Drejtoria Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejshëm: DPB) të cilat ishin regjistruar nën rastin nr. DS007396 dhe DS301357. Paditësi parashtrroi një padi si e kategorisë A kurse i padituri i parë si i kategorisë C.

Me Vendim nr. HPCC/D/197/2005/A&C datë 18 Qershor 2005 Komisioni për Padi Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejme: KPPB) vendosi mbi paditë e mësipërme duke urdhëruar se kategoria A e padisë të i jepet dhe ti kthehet e drejta pronësore paditësit. Paditësi i Kategorisë A u urdhërua të paguajë shumën në pajtim me nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 (në tekstin e mëtejme: UNMIK/REG/2000/60). Pas pagesës së shumës Komisioni do të nxjerrë një vendim përfundimtar për dhënien e pronësinë së banesës për paditësin e kategorisë A. Nëse paditësi i kategorisë A do të paguajë shumën e përmendur, paditësi i kategorisë C nuk do të ketë të drejtë të posedimit, sipas padisë së tij përkatëse, por do të ketë të drejtë, në bazë të kërkesës, të kompensohet nga Drejtoria për shumën që ai kishte paguar për blerjen pronës, plus një përqindje të vlerës aktuale të pronës në treg, si dhe për shpenzimet e çfarëdo përmirësimi/rregullimi që ai kishte bërë në banesë. Dhe në qoftë se paditësi i kategorisë A nuk do të paguajë shumën e përmendur, atij do të lëshohet një certifikatë nga Drejtoria sipas nenit 4.4 të UNMIK/REG/2000/60 dhe paditësi i kategorisë C do të ketë të drejtën e posedimit të pronës se qe është objekt i padisë.

Pas kërkesës se paraqitur për ri-konsiderim nga paditësi i kategorisë C, KPPB lëshoi një Vendim mbi Kërkesën për Ri-konsiderim nr. KPPB/REC/65/2006 të datës 15 Korrik 2006. Me këtë vendim kërkesa për rikonsiderim u miratua, dhe vendimi i Komisionit me nr. KPPB/D/197/2005/A&C u hodh poshtë dhe ne lidhje me paditë e kategorisë A dhe kategorisë C u lëshua një vendim i ri.

Bazuar në këtë vendim të ri padia e kategorisë A (padia e paraqitur nga paditësi) është refuzuar dhe përcaktimi i ndihmave ligjore, nëse ka ndonjë, që mund të jenë në dispozicion për paditësin e kategorisë A sipas ligjit të aplikueshëm si pasojë e mënyrës së pretenduar të jete e parregullt në të cilën prona e pretenduar është ndare për paditësin e kategorisë C, ka qenë e drejtuar gjykatës kompetente vendore. Me të njëjtin vendim është dhënë posedimi i pronës kontestuese tek paditësi i kategorisë C.

Së pari Gjykata thekson se sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 (në tekstin e mëtejme: UNMIK/REG/1999/23) dhe UNMIK/REG/2000/60 DÇPB dhe KPPB u është dhënë mandati për të proceduar dhe gjykuar të gjitha paditë pronësore dhe banesore lidhur me të drejtat pronësore.



Në bazë të nenit 2.1 të UNMIK/REG/1999/23 KPPB ( "Komisioni") është organ i pavarur i Drejtorisë i cili do të zgjedhë kontestet private e jo-komerciale lidhur me pronën banesore që i referohen nga Drejtoria derisa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm konstaton se gjykatat lokale janë në gjendje për të kryer funksionet e besuara pranë Komisionit.

Për më tepër në bazë të nenit 2.7 të UNMIK/REG/1999/23 vendimet përfundimtare të Komisionit janë detyruese dhe të ekzekutueshme, dhe nuk janë objekt rishqyrtimi nga ndonjë autoritet tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.

Në bazë të nenit 3.1 të UNMIK/REG/2000/60 asnjë kërkesë për rikthimin e pronës banesore të humbur ndërmjet datës 23 Mars 1989 dhe 24 Mars 1999 si pasojë e diskriminimit mund të bëhet tek çdo gjykatë apo tribunal në Kosovë, përveç në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 dhe rregulloret në fuqi.

Komisioni ka të drejtë të referoi çështjet që ngritën në lidhje me një padi, të cilat nuk janë brenda juridiksionit të një gjykatë kompetente vendore ose ndonjë bordi administrativ apo tribunali siç është paraparë në nenin 22.1 të UNMIK/REG/2000/60.

Gjithashtu, në pajtim me nenin 2.5 të UNMIK/REG/1999/23 Komisioni mund t'u drejtojë pjesë të veçanta të kërkesave të tilla në gjykatat vendore apo organet administrative, nëse gjykimi i atyre pjesëve të ndara nuk ngritë çështjet e renditura në nenin 1.2.

Gjykata konstaton se Rregulloret e sipërpërmendura të UNMIK-ut duhet të zbatohen në këtë kontest civil.

Me padinë ndryshuar paditësi ka kërkuar nga gjykata për të konfirmuar se kontrata nr. 973 e lidhur më 11 Nëntor 1993 në mes të paditurit të dytë , Bibliotekës Kombëtare Universitare, dhe paditurit të parë, M. M. si blerës, nuk është e vlefshme - dhe është absolutisht e pavlerë dhe të konfirmoj që paditësi H.Sh. nga Prishtina është mbajtësi i drejtës banesore të banesës që gjendet

në Prishtinë, Dardania SU-3/2, kati i dyte, hyrja A, banesa numër 11 me sipërfaqe prej 58,11 m<sup>2</sup>sipërfaqe, në bazë të kontratës së përdorimit të banesës nr. 1193/11934, të datës 20 Korrik 1984.

Kur testohet dhe vendoset mbi një padi aq të ndryshuar, gjykata duhet të vë theksin mbi dy fakte vendimtare.

E para është pyetja nëse paditësi ka legjitimitetin e palës në këtë procedure civile.

Pasi që padia e kategorisë A i është refuzuar paditësit me Vendimin mbi Ri-konsiderimin gjykata nuk mund ta gjejë paditësin si “ palë të interesuar” në pajtim me Nenin 109 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (në tekstin e mëtejme LMD).

Ai do të mund të ishte “palë e interesuar” nëse ai dëshmon se në rast të suksesit për deklarimin e invaliditetit të transaksionit ai mund të mbaj të drejtën apo beneficinin siç është me ligj.

Paditësi kërkon nga gjykata që të konfirmoj se kontrata nr. 973 e lidhur me 11 Nëntor 1993 në mes të Bibliotekës Kombëtare Universitare dhe të paditurit M. M. si blerës, nuk është valide – absolutisht e pavlere. Pas kësaj kërkesë, nëse do të miratohej, paditësi do të mbaj të drejtën të konfirmoj se ai është personi që ka të drejtën banesore të banesës.

Mirëpo gjykata duhet të vë në theks prapë se kjo padi të konfirmoj se ai është zotërues i të drejtës banesore të banesës, është vendosur dhe refuzuar nga KPPB-ja me Vendimin mbi Kërkesën për Ri-konsiderim nr. HPPC/REC/65/2006 të datës 15 Korrik 2006 e lëshuar nga KPPB-ja ( në tekstin e mëtejme: Vendimi mbi Rikonsiderim).

Edhe një herë, në pajtim me Nenin 2.7 të UNMIK/REG/1999/23 vendimet përfundimtare të Komisionit janë detyrues dhe të ekzekutueshëm dhe nuk mund të rishqyrtohen nga gjykata.

Pra paditësi nuk e ka dëshmuar se ai mund të zotëroi të drejtën apo çfarëdo beneficioni tjetër në rast se kontrata apo blerja e banesës do të deklarohej si e paligjshme.

E dyta është pyetja nëse kërkesë-padia e ngritur nga paditësi është në përputhje me Vendimin mbi Rikonsiderim.

Padia e paditësit e ngritur me KPPB-në ishte konsideruar të jete padi e kategorisë A në pajtim me Nenin 1.2 të UNMIK/REG/1999/23 dhe Nenin 2.2 të UNMIK/REG/2000/60.

Në pajtim me Nenin 2.2 të UNMIK/REG/2000/60 çdo person e drejta e pronës e të cilit është humbur në mes të 23 Mars 1989 dhe 24 Mars 1999 si rezultat i diskriminimit ka t; drejta kthimi në pajtim me rregulloret e tanishme. Kthimi mund të behet ne forme të kthimit të se drejtës së pronës apo me kompensim.

Paditësi si kategorisë A i cili kërkon kthimin e të drejtës pronësore duhet të dëshmoje se :

- Ai apo ajo ka pasur të drejtën pronësore te shtëpisë se banimit apo banesës;
- E drejta e pronës është e mundur qe të kthehet;
- E drejta është revokuar apo humbur ;
- Humbja apo revokimi ka ndodhur ne mes të 23 Mars 1989 dhe 24 Mars 1999; dhe
- Humbja po revokimi ka qene rezultat i diskriminimit.

Konsiderohet se paditësi e ka fituar të drejtën e zotërimit të banimit nëse ai apo ajo:

- Ka mare vendimin nga mbajtësi i të drejtës për ndarje qe ti ndahet banesa atij apo asaj;
- Ka lidhur kontrate të vlefshme për përdorim , dhe
- Është vendosur ne banese ne mënyre të ligjshme.

Me Vendimin nr. KBBP/D/197/2005/A&C të datës 18 Qershor 2005 ( ne tekstin e mëtejme: Vendimi i KPPB-së) padia e kategorisë A është miratuar pasi qe të gjitha kërkesat e duhura dhe të përmendura ne dy paragrafët e mëparshëm janë përmbushur.

Paditësi i kategorisë C ( i padituri i pare në këtë lëndë) ka kërkuar Rikonsiderimin e Vendimit të KPPB-se duke pretenduar se vendimi mbi ndarje për paditësin e kategorisë A ka qenë i anuluar nga Gjykata Themelore e Punës Bashkuar në Prishtine ne vitin 1984 në procedure gjyqësore jo diskriminuese. Ky vendim është konfirmuar nga Gjykata e Punës se Bashkuar të Kosovës ne vitin 1985. Në mbështetje të pretendimeve paditësi i kategorisë C paraqiti kërkesën për dëbim nga banesa të paditësit të kategorisë A, për të cilën i referohet vendimit ne fjale të gjykatës.

Me Vendimin mbi Rikonsiderim padia e paditësit me KPPB-në , refuzohet kërkesa për kthimin e drejtës pronësore. Si arsyetim për një vendim të tille KPPB-ja deklaroi ne pikën 9 se Komisioni gjeti se, në bazë të provave të reja të paraqitura Pala Kërkuuese (në këtë çështje civile paditësi i kategorisë C dhe i padituri i parë) se Pala Përgjegjëse (paditësi i kategorisë A, paditësi në këtë

çështje civile) dështoi të demonstroi se ai humbi të drejtën e pronës si rezultat i diskriminimit siç e parasheh neni 2.2 i UNMIK/REG/2000/60. Gjithashtu thuhet se nëse ai ishte dëbuar me 1993 dëbimi do të ishte bazuar në vendimet e gjykatës relevante para 1989 që nuk ka dëshmuar të jete motivuar nga diskriminimi.

Siç thuhet në arsyetim, Komisioni ka qenë i mendimit se paditësit i ishte parandaluar të marre pjese ne procesin e ri-ndarjes se banesës si rezultat i diskriminimit dhe se aspekt duhet të merret parasysh nga gjykatat vendore që kane ingerenca.

Dhe krejt ne fund gjykata duhet të potencoij gjithashtu faktin se kthimi i të drejtës banesore për banesat në pronësi sociale i cili ka pësuar si rezultat i diskriminimit ne Nenet 3 dhe 4 të UNMIK/REG/2000/60 e cila specifikon kthimin për paditësin e kategorisë A mund ta marre edhe formën e kthimit të të drejtës pronësore- kthim të njëjtë apo kompensim të hollash.

Pasi që padia e paditësit për kthim të të drejtës se pronës ishte refuzuar me Vendim të KPPB-së, dhe se vendimi në fjale ka formën e prere dhe nuk mund të rishqyrtohet nga gjykata, sipas dispozitave të larte-përmendura të UNMIK/REG/2000/60 paditësi mund të kërkoj vetëm kompensim në të holla nëse të gjitha kushtet tjera janë plotësuar.

Për sa i përket udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Qarkut që të udhëzohen palët të i paraqesin gjykatës vendimet e Gjykatës Themelore të Punës se Bashkuar dhe Gjykatës së Punës se Bashkuar të Kosovës dhe natyrisht të i shqyrtoi ato, gjykata gjen si në vijim.

Gjykata ka kërkuar nga i padituri i parë të paraqes të dy vendimet pasi qe ai i prezantoi ato si prova. Vendimet nuk u parashtruan nga i padituri i parë as nga i dyti e as nga paditësi. Të gjithë ata theksuan se nuk i kane ato në posedim.

Paditësi tha ne deklaratën e tij se ai kurrë nuk ka dëgjuar asgjë prej tyre dhe se nuk i kishte parë ata. Atij, njerëzit nga biblioteka i kishin thënë se kushdo që ishte ankuar në lidhje me këtë banesë, ata nuk i përfillnin ato ankesa “ për shkak se banesa ishte e tij”.

I padituri i parë gjithashtu nuk ishte ne posedim të tyre por se e mori vesh për to në vitin 1991 kur ai filloi të punonte në bibliotekë. Si sekretar i bibliotekës që ishte, ai përgatiti kërkesën për Komunë, si autoritet administrativ për çështjet banesore për lëshimin e vendimeve për dëbim nga

banesa. Kërkesa në fjalë u paraqit gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur më 19 Mars 2013 por nuk u lejua të pranohet si provë pasi që nuk ishte propozuar gjatë seancës paraprake në pajtim me Nenin 428 , paragrafi 2 të LPK-së.

Me letrën e datës 16 Prill 2013 gjykata sipas detyrës zyrtare kërkoi vendimet prej Gjykatës Themelore të Prishtinës pasi që kjo gjykatë mban arkivin e ish- Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar dhe Gjykatës së Punës së Bashkuar të Kosovës. Më 17 Maj 2013 gjykata mori përgjigjen se dosja e lëndës nuk ishte gjetur në arkiv.

Sidoqoftë gjykata duhet të potencoi prapë se këto vendime tashmë janë shqyrtuar nga KPPB-ja. Ato ishin prezantuar si prova të reja në procedure tek KPPB-ja dhe duke u bazuar në to Komisioni gjeti se paditësi dështoi të demonstroi se ai e humbi të drejtën pronësore si rezultat i diskriminimit, siç e rregullon neni 2.2 të UNMIK/REG/2000/60 dhe se dëbimi nga banesa ishte bazuar mbi vendimet e gjykatave relevante para vitit 1989 që nuk kanë dëshmuar të jenë motivuar nga diskriminimi.

Dhe se siç edhe është potencuar me herët vendimet e nxjerra nga Komisioni janë detyruese dhe nuk mund të ri-shqyrtohen nga gjykata.

Nga e gjithë kjo që u tha më lart, gjykata ka shqyrtuar se në këtë lëndë kushtet ligjore nuk janë plotësuar në pajtim me dispozitat e UNMIK/REG/2000/60 dhe UNMIK/REG/1999/23, e posaçërisht në pajtim me Nenin 3 dhe 4 të UNMIK/REG/2000/60 dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në pajtim me Nenin 452 paragrafi 1 i LPK-së gjykata vendosi që paditësi duhet të i kthej paratë e shpenzimeve që i janë shkaktuar të paditurit të parë. I padituri i dytë nuk ka kërkuar shpazim të shpenzimeve të tij/saj.

Kur bëhet vlerësimi i shpenzimeve në pajtim me nenin 453 paragrafi 1 dhe 2 i LPK gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe vendosi që kërkesa e paraqitur nga përfaqësuesi i të paditurit të parë në shumë prej 300 EUR; 100 EUR për secilën seancë, është i bazuar.

**Këshillat juridike :**

Palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi tek Gjykata e Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës brenda pesëmbëdhjete (15) ditësh prej ditës kur kopja e këtij aktgjykimi u është dhënë palëve.

**Gjykata Themelore në Prishtinë**

**C.nr. 2147/09**

**16 Prill 2013**

E përpiluar ne gjuhen Angleze

Si gjuhë e autorizuar

Kryetarja e trupit Gjykses

Franciska Fiser